



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL  
DREJTORIA JURIDIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Tiranë, më 05.08.2024

### NJOFTIM PUNËSIMI

Në zbatim të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, të VKM nr. 719, datë 31.10.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, i ndryshuar, si dhe në VKM nr. 39, datë 24.01.2024, “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2024, në njësitë e qeverisjes qendrore”,

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural shpall njoftimin e punësimit për vendin e pa plotësuar si më poshtë vijon :

#### I. DREJTORIA E KONTROLLIT

##### ➤ SEKTORI I KONTROLLIT TË SKEMAVE KOMBËTARE

SPECIALIST (me kontratë pune të përkohshme 6h/ditë)

##### ➤ Detyrat kryesore:

- Siguron marrjen në dorëzim dhe kontrollin fizik të dosjeve për aplikimet e vlerësura fituese nga komisionet e vlerësimit.
- Kryen verifikime në terren duke krahasuar rezultatet e faktit në terren me ato të aplikimit dhe duke i reflektuar në formularin e verifikimit, bazuar në planet e punës, të miratuara nga drejtori i drejtorisë si dhe programet e përkatëse të punës.
- Analizon dhe verifikon rezultatet e kontrollit, formularin e verifikimit dhe detyrat e tjera të ngarkuara nga drejtoria.
- Përgatit raportet e kontrollit në vend brenda afateve sipas masave mbështetëse, pas përfundimit të kontrollit në vend, në zbatim të manualit të procedurave.
- Dorëzon dosjet së bashku me formularin e verifikimit pranë Agjencisë së Pagesave, në Drejtorinë e përcaktuar sipas Udhëzimit dhe Rregullores së Brendshme.
- Raporton tek përgjegjësi i sektorit dhe drejtori i drejtorisë mbi kryerjen e detyrave kryesore të përcaktuara.
- Identifikon dhe raporton parregullsitë/red flag e hasura gjatë procesit të punës në përputhje me manualet e procedurave.
- Kryen detyra të tjera të ngarkuara nga eprori përkatës.

➤ **Kandidatët e interesuar duhet të përmbushin këto kritere:**

1. Diplomë e nivelit “Bachelor” në Arsim i Lartë. Diplomat e marra jashtë vendit duhet të jenë të njohura paraprakisht nga institucioni përgjegjës për njehësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.
2. Të kenë aftësi shumë të mira komunikuese.
3. Të kenë njohuri bazë në përdorimin e kompjuterit
4. Të kenë njohuri bazë mbi zhvillimin bujqësor dhe rural në Shqipëri.
5. Preferohet të kenë përvojë pune ose internshipi/praktika profesionale.

➤ **Kandidatët do të testohen në lidhje me:**

- Ligjin nr. 9817, datë 22.10.2007 “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”;
- VKM nr. 719, datë 31.10.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9131, datë 8.9.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”.

**Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë brenda datës 07.08.2024, ora 16.30 në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (Adresa: Rruga “Muhamet Gjollësja”, Nr. 56, Tiranë): Kërkesën për punësim ku duhet të përcaktojnë pozicionin për të cilin po aplikojnë; një kopje të CV të përditësuar; diplomën e noterizuar; certifikata dhe kualifikime të ndryshme; një fotokopje e librezës së punës; një kopje të ID-së; formularin e vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore të firmosur nga aplikuesi; raportin mjeko-ligjor.**

---

**TË GJITHË KANDIDATËT QË APLIKOJNË PËR POZICIONET E MËSIPËRME, DO TË MARRIN INFORMACION VETËM NË FAQEN E INTERNETIT TË AZHBR [www.azhbr.gov.al](http://www.azhbr.gov.al), PËR FAZAT E MËTEJSHME TË KËSAJ PROCEDURE:**

- për rezultatet e verifikimit
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi (testim me shkrim/ intervista me gojë)
- shpalljen e listës së fituesve

**Për të marrë këto informacione, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e internetit të AZHBR [www.azhbr.gov.al](http://www.azhbr.gov.al).**

**AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL**